FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.37 12 mars 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9878 datë 21.2.2008	Për ratifikimin e "Marrëveshjes për ngritjen dhe veprimtarinë e Observatorit të Transportit për Europën Juglindore (SEETO)".	1673
Vendim i Kuvendit nr.163, datë 3.3.2008	Për zgjedhjen e një anëtari zëvendësues të Këshillit Drejtues të RTSH-së …….....	1679
Vendim i Kuvendit nr.164, datë 3.3.2008	Për shkarkimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ……	1680
Vendim i Kuvendit nr.165, datë 3.3.2008	Për shkarkimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ……	1680
Vendim i Kuvendit nr.166, datë 3.3.2008	Për shkarkimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ……	1681
Vendim i Kuvendit nr.167, datë 3.3.2008	Për shkarkimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ……	1681
Dekret nr.5651 datë 7.3.2008	Për falje dënimi ……	1682
Vendim i ERE nr.28, datë 4.3.2008	Për kërkesën e shoqërisë "ACR Energy" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..	1683
Vendim i ERE nr.29, datë 4.3.2008	Për kërkesën e shoqërisë "ERS-08" sh.p.k.. për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimit të energjisë elektrike …….	1684
Vendim i ERE nr.30, datë 4.3.2008	Për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., për shtyrjen e vendimmarrjes për pajisjen me licencë..	1685

LIGJ
Nr.9878, datë 21.2.2008

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES PËR NGRITJEN DHE VEPRIMTARINË E OBSERVATORIT TË TRANSPORTIT PËR EUROPËN JUGLINDORE (SEETO)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja për ngritjen dhe veprimtarinë e Observatorit të Transportit për Europën Juglindore (SEETO)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5649, datë 6.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJA
MBI NGRITJEN DHE VEPRIMTARINË E SEETO-S

Hyrje

Në lidhje me funksionimin e Vëzhguesit të Transportit të Europës Juglindore (më poshtë SEETO), i ngritur në vijim të Memorandumit të mirëkuptimit mbi zhvillimin e rrjetit kryesor të transportit rajonal në Europën Juglindore, nënshkruar më 11 qershor 2004, nga Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, Serbia, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë dhe Kosova[1] së bashku me Komisionin Europian, që së bashku quhen "Pjesëmarrësit", kanë ngritur një komitet drejtues në përputhje me nenin 9 të Memorandumit të mirëkuptimit dhe me anë të kësaj vendosin që veprimtaria e SEETO-s të jetë në përputhje me parimet e mëposhtme:

I. Neni i përgjithshëm

Neni 1

Njohja dhe pranimi i termave të referencës për krijimin e SEETO-s të përgatitur nga Bashkimi Europian referenca EuropAid/116965/C/SV/Multi dhe dhënia në vijim e një kontrate të shërbimeve të KE për GOPA dhe TRADEMCO, që do të njihen së bashku si "Konsulentët".

II. Zyra qendrore

[1] Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara i Administrimit në Kosovë që vepron për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes.

Neni 2

Në përputhje me MM, seksioni X, zyra qendrore e Sekretariatit të Përhershëm të SEETO-s është në Beograd-New Belgrade, Omladinskih brigada no.1, e pritur nga Republika e Serbisë.

Zyrat e koordinimit kombëtar janë në qytetet kryesore respektive të Pjesëmarrësve.

III. Objektivat dhe misioni i SEETO-s

Neni 3

Objektivi i përgjithshëm i SEETO-s është të lehtësojë, së bashku ose veçmas, Pjesëmarrësit në zbatimin e Memorandumit të mirëkuptimit për zhvillimin e rrjetit rajonal kryesor të transportit në Europën Juglindore.

Objektivat e veçantë të SEETO-s janë:

Të përgatisë një plan pune shumëvjeçar me bazë 5-vjeçare për zhvillimin e rrjetit kryesor të transportit rajonal në Europën Juglindore.

Të përgatisë dhe të mirëmbajë një sistem informacioni që do të përdoret nga vendimmarrësit dhe aktorë të tjerë të përfshirë në zhvillimin e rrjetit kryesor të transportit rajonal në Europën Juglindore.

Të sigurojë ndihmë në forcimin e kapaciteteve rajonale planifikuese.

Të sigurojë një platformë për përdorimin efiçent të fondeve dhe ekspertizën e siguruar nga burimet publike dhe private.

Misioni i SEETO-s është të përmirësojë dhe modernizojë rrjetin kryesor të transportit në Europën Juglindore për zhvillimin ekonomik dhe social.

IV. Objekti i punës së SEETO-s

Neni 4

Për objektin e punës së SEETO-s bihet dakord nga komiteti drejtues dhe përfshin koordinimin dhe organizimin e aktiviteteve për zbatimin e MM-së, mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi rrjetin rajonal kryesor të transportit, planifikimin dhe rishikimin e zhvillimit të rrjetit kryesor, monitorimin e zbatimit të planit, lehtësimin e reformave, studime dhe analizime, raportime dhe publicitet.

V. Interesat promovuese të SEETO-s për rrjetin kryesor të transportit rajonal

Neni 5

SEETO ka përgjegjësinë për të nxitur interesat e Pjesëmarrësve në zhvillimin e rrjetit kryesor të transportit rajonal në lidhje me agjencitë ndërkombëtare përkatëse, grupin drejtues për infrastrukturën e Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore dhe sekretariatet e korridoreve përkatëse.

VI. Rrjeti kryesor i transportit rajonal

Neni 6

Rrjeti rajonal kryesor i transportit për të cilin SEETO luan një rol këshillues dhe bashkërendues, përcaktohet në Memorandumin e mirëkuptimit ose siç ndryshohet në vijim.

Neni 7

Modifikimet e rrjetit kryesor të transportit rajonal i njoftohen SEETO-s nga Pjesëmarrësit përkatës.

SEETO paraqet njoftimin në fjalë për miratim në komitetin drejtues, nëse modifikimi

konsiderohet të jetë i një rëndësie rajonale.

SEETO bën një përshkrim preciz të rrjetit kryesor të transportit rajonal, të cilin do ta përfshijë në planin shumëvjeçar të përmendur në nenin 20.

VII.Organizimi i SEETO-s

Neni 8

Komiteti drejtues bie dakord për organizimin e SEETO-s dhe reflekton kërkesat e qëllimit të punës (referuar nenit 4 të Marrëveshjes).

SEETO ka tri funksione, në veçanti koordinimin, planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të informacionit.

Neni 9

SEETO përfshin një sekretariat teknik dhe zyrat e koordinimit kombëtar.

VIII.Bazat ligjore dhe fiskale të SEETO-s

Neni 10

Procesi i regjistrimit të SEETO-s rregullohet përmes caktimit të Memorandumit të statusit ligjor të SEETO-s me qeverinë pritëse të Republikës së Serbisë dhe Konsulentët (referuar nenit 1).

Baza ligjore dhe fiskale e SEETO-s është në përputhje me ligjet dhe rregullat në Republikën e Serbisë.

IX. Marrja në punë e personelit nga SEETO

Neni 11

Personeli i punësuar nga SEETO merret nga juridiksionet e Pjesëmarrësve dhe kontaktohen në SEETO në përputhje me procedurat dhe kërkesat e vendosura nga komiteti drejtues.

Personeli i punësuar nga SEETO u nënshtrohet ligjeve të punësimit dhe rregullave të Republikës së Serbisë.

X. Koordinimi kombëtar i SEETO-s

Neni 12

Koordinimi kombëtar i SEETO-s kryhet nëpërmjet një koordinatori kombëtar të SEETO-s, i caktuar nga çdo Pjesëmarrës.

Koordinatorët kombëtarë janë përgjegjës për prezantimin e SEETO-s në juridiksionet e çdo Pjesëmarrësi.

Roli i koordinatorit kombëtar është që të lehtësojë veprimtarinë ditore të SEETO në fushën e çdo partneri, të vëzhgojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet enteve kombëtare të transportit dhe Sekretariatit të SEETO-s dhe të koordinojë të gjitha aktivitetet brenda fushës së çdo partneri për të zbatuar Memorandumin e mirëkuptimit.

Përshkrimi i punës së koordinatorit kombëtar përcaktohet nga komiteti drejtues.

Pjesëmarrësit duhet t'u sigurojnë koordinatorëve kombëtarë kohën e duhur, burimet dhe autorizimin e nevojshëm për të çuar përpara pozicionin.

XI. Sekretariati i përhershëm i komitetit drejtues të zhvillimit të rrjetit kryesor

Neni 13

SEETO siguron një sekretariat të përhershëm të komitetit drejtues për zhvillimin e rrjetit rajonal kryesor të transportit në Europën Juglindore.

XII. Financimi i SEETO-s

Neni 14

Buxheti vjetor i SEETO-s përfshin, megjithëse jo i kufizuar, shpenzimet që vijnë nga shpërblimet e personelit, kostot e menaxhimit të zyrës, sistemi i informacionit dhe komunikimi, shpenzimet e zakonshme, shpenzimet operacionale, studime rajonale dhe takimi vjetor i ministrave, takime dhe seminare të tjera.

Neni 15

SEETO prezanton buxhetin e tij vjetor për miratim nga komiteti drejtues jo më vonë se 1 korriku i çdo viti. Takimi vjetor i ministrave duhet të miratojë buxhetin. Pjesëmarrësit kontribuojnë 25% të buxhetit të miratuar në 2006, 50% në 2007 dhe 100% nga 2008. Pjesëmarrësit financojnë plotësisht buxhetin e adoptuar të SEETO-s nga 1 janari 2008. Pas kësaj, Pjesëmarrësit kontribuojnë 50% të buxhetit në ditën e parë të qershorit dhe dhjetorit për çdo vit operacional.

Neni 16

Kontributi i çdo partneri për buxhetin operacional të SEETO-s sigurohet nga çdo Pjesëmarrës nga ministritë e financave të qeverive.

Shuma e kontributit të secilit pjesëmarrës është në raport me përqindjen e shumës financiare për të gjitha projektet e pjesëmarrësit në të gjitha projektet e të gjithë Pjesëmarrësve që përfshihen në planin e veprimit vjetor.

Kontributet në SEETO në natyrë nuk konsiderohen si pjesë e kontributit të buxhetit të mandatuar të Pjesëmarrësve.

XIII. Raporti vjetor i SEETO-s

Neni 17

SEETO përgatit një raport vjetor që përmban një llogari auditimi të detajuar në mënyrë të pavarur për shpenzimet e vitit aktual fiskal dhe buxhetin për vitin në vijim për miratim nga komiteti drejtues.

Komiteti drejtues kërkon një auditor të pavarur për auditimin e llogarive të SEETO-s, shpenzimet e të cilit do të financohen nga buxheti i SEETO-s.

XIV. Gjuhët e punës

Neni 18

Gjuha e punës e SEETO-s është anglishtja.

XV. Sistemi i informacionit i SEETO-s

Neni 19

Pjesëmarrësit kërkojnë që SEETO të mbajë një sistem efiçent dhe efektiv informacioni, që është i arritshëm nga të gjithë Pjesëmarrësit dhe përdorues të tjerë, i miratuar nga komiteti drejtues.

Pjesëmarrësit kërkojnë që SEETO të ketë një faqe interneti.

XVI. Sigurimi dhe përdorimi i informacionit

Neni 20

Pjesëmarrësit njohin rëndësinë e shkëmbimeve efektive të informacionit dhe marrin përsipër të sigurojnë autorizimin e përshtatshëm për lëshimin e të dhënave dhe në kohë për SEETO-n, për të përmbushur qëllimin e tij të punës.

Pjesëmarrësit sigurojnë informacionin dhe të dhënat pa kosto për SEETO-n ose ndonjë konsulent të angazhuar për ose në emër të SEETO-s.

Termat dhe kushtet për shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve brenda sistemit të informacionit të SEETO-s përcaktohen në marrëveshje ndërmjet përdoruesve të sistemit dhe SEETO-s dhe të vërtetuara nga koordinatorët kombëtarë.

XVII. Përgatitja e planit për zhvillimin e rrjetit rajonal kryesor të transportit

Neni 21

SEETO përgatit një plan pune shumëvjeçar, me bazë 5-vjeçare, për zhvillimin dhe përmirësimin e rrjetit kryesor të transportit rajonal në Europën Juglindore, në përputhje me aneksin A të Memorandumit të mirëkuptimit.

SEETO përgatit planin sipas një formati të miratuar nga komiteti drejtues.

Metodologjia dhe procedurat për përgatitjen e planit duhet të marrin në konsideratë proceset kombëtare të planifikimit të çdo Pjesëmarrësi dhe miratohet nga komiteti drejtues.

Pjesëmarrësit miratojnë planin e takimit vjetor të ministrave.

XVIII. Lehtësimi i reformave të nevojshme për zhvillimin e rrjetit kryesor të transportit rajonal

Neni 22

SEETO asiston partnerët për të zhvilluar reformat në politikën dhe menaxhimin e sektorit të transportit duke dhënë këshilla dhe duke kryer studime të tilla rajonale ose aktivitete siç kërkohen nga komiteti drejtues.

XIX.Prezantimi i informacionit të projektit në SEETO

Neni 23

Pjesëmarrësit pranojnë përdorshmërinë e një metodologjie të pranuar bashkërisht për zhvillimin e rrjetit rajonal kryesor të transportit dhe marrin përsipër të paraqesin informacione mbi projektet dhe aktivitete për përfshirje në planin e punës shumëvjeçar, me bazë 5-vjeçare, në një format të rënë dakord bashkërisht që jepet nga SEETO.

SEETO-s mund t'i kërkohet të sigurojë këshilla për Pjesëmarrësit në përgatitjen e projekteve për përfshirje në plan.

XX.Monitorimi i zbatimit të zhvillimit të rrjetit kryesor të transportit rajonal

Neni 24

SEETO monitoron përmirësimiet e rrjetit kryesor të transportit rajonal duke përdorur tregues të miratuar nga komiteti drejtues, bazuar në të dhëna të siguruara nga Pjesëmarrësit.

XXI. Vendimmarrja në lidhje me zbatimin e Memorandumit të mirëkuptimit

Neni 25

Takimi vjetor i ministrave krijon mundësinë e një forumi ku bëhen planifikime dhe merren vendime të tjera në lidhje me zbatimin e Memorandumit të mirëkuptimit për zhvillimin e rrjetit kryesor të transportit rajonal në Europën Juglindore.

Vendimet bazohen në rekomandimet e dala nga komiteti drejtues, siç këshillohet nga Sekretariati i tij.

XXII. Ndryshimet në Marrëveshjen e SEETO-s

Neni 26

Pjesëmarrësit pranojnë që ndryshimet në Marrëveshjen e SEETO-s ose në komponentët e tij të ndryshëm ose përfundimi mund të bëhet me konsensusin e komitetit drejtues (përveç kapitullit XII "Financimi i SEETO-s").

Ndryshimet në kapitullin XII "Financimi i SEETO-s" duhet të kalojnë të njëjtën procedurë të kësaj Marrëveshjeje.

XXIII. Procedura e zbatimit

Neni 27

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit nga parlamenti ose qeveria e secilit vend.

Nënshkruar në Shkup, më 10 nëntor 2005.

Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Z. Lulzim BASHA

Ministër i Transportit dhe Komunikacionit

Mr Branko DOKIC

Ministër i Detit, Turizmit, Transportit dhe Zhvillimit

Z. Božidar KALMETA

Ministër i Investimeve të Kapitalit

Z. Velimir ILIĆ

Ministër i Çështjeve Detare dhe Transportit

Z. Andrija LOMPAR



Ministër i Transportit dhe Komunikacionit

Z. Xhemali Mehazi



Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë që vepron për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes

Z. Johan van Lamoen



Komisioni Europian

Z. Edgar THIELMANN

VENDIM
Nr.163, datë 3.3.2008

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI ZËVENDËSUES TË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH-SË

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe të neneve 88 dhe 93 pika 4 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ilir Nikolla zgjidhet në detyrën e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së në vend të zotit Mero Baze, i cili ka dhënë dorëheqjen.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM

Nr.164, datë 3.3.2008

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 84 dhe 86 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Hydajet Kopani shkarkohet nga detyra e anëtarit dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.165, datë 3.3.2008

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 84 dhe 86 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Anila Kaçupi shkarkohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.166, datë 3.3.2008

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 84 dhe 86 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Shyqyri Meka shkarkohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.167, datë 3.3.2008

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 84 dhe 86 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Arjan Sinoimeri shkarkohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.5651, datë 7.3.2008

PËR FALJE DËNIMI

Në mbështetje të nenit 92, pika “b”, dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 70 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, nenit 1 të ligjit nr.6299, datë 27.3.1981 “Për faljen”, të ndryshuar, me propozim të organeve të pushtetit lokal dhe të institucioneve të tjera,

DEKRETOJ:

Neni 1

1. Afërdita Zeqo Lilaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.260, datë 11.10.2004, i falet dënimi i mbetur.

2. Arjana Fadil Alla, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.344, datë 8.4.2004, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

3. Bedrije Veiz Veizati, dënuar nga Gjykata e Rrethit Sarandë, me vendimin nr.20, datë 6.3.2003, ndryshuar me vendimin nr.68, datë 9.7.2003 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, i falet dënimi i mbetur.

4. Dallëndyshe Islam Dollani, dënuar nga Gjykata e Rrethit Berat, me vendimin nr.1, datë 10.1.2005, i falet dënimi i mbetur.

5. Dava Preng Nikolli, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mirditë, me vendimin nr.50, datë 16.6.2004, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

6. Dilbere Mat Zhubi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kavajë, me vendimin nr.37, datë 15.3.2005, i falen 3 vjet nga dënimi i mbetur.

7. Diana Demir Luli, dënuar nga Gjykata e Rrethit Elbasan, me vendimin nr.180, datë 12.7.2005 i falet dënimi i mbetur.

8. Flora Maliq Greku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Fier, me vendimin nr.56, datë 1.3.2005, i falet dënimi i mbetur.

9. Hyrie Osmen Greku, dënuar mga Gjykata e Rrethit Fier, me vendimin nr.58, datë 4.3.2005, i falet dënimi i mbetur.

10. Jonida Prokop Kajana, dënuar nga Gjykata e Rrethit Durrës, me vendimin nr.110, datë 22.2.2007, i falet dënimi i mbetur.

11. Katerina Zef Qytetaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Shkodër, me vendimin nr.308, datë 18.12.2002, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

12. Leko Pelivan Greku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Fier, me vendimin nr.205, datë 21.9.2005, i falet dënimi i mbetur.

13. Liri Bajram Çepele, dënuar nga Gjykata e Rrethit Fier, me vendimin nr.309, datë 21.12.2005, i falet dënimi i mbetur.

14. Mimoza Mustafa Shota, dënuar nga Gjykata e Rrethit Krujë, me vendimin nr.124, datë 8.12.2003, i falet dënimi i mbetur.

15. Miranda Novruz Pano, dënuar nga Gjykata e Rrethit Berat, me vendimin nr.141, datë 13.10.2006, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

16. Naslie Xheladin Veizi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Dibër, me vendimin nr.71, datë 26.10.1993, i falet dënimi i mbetur.

17. Nusha Mark Ceci, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mirditë, me vendimin nr.17, datë 24.3.2005, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

18. Nafije Bece Shquti, dënuar nga Gjykata e Rrethit Korçë, me vendimin nr.111, datë 15.3.2007, i falet dënimi i mbetur.

19. Ornela Çelnik Capo, dënuar nga Gjykata e Rrethit Korçë, me vendimin nr.344, datë 20.12.2005, ndryshuar me vendimin nr.644, datë 17.10.2007 të Gjyaktës së Lartë, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

20. Oskeola Mazllem Qosja, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.695, datë 1.6.2007, i falet dënimi i mbetur.

21. Qazime Qani Ferro, dënuar nga Gjykata e Rrethit Fier, me vendimin nr.199, datë 15.9.2005, i falet dënimi i mbetur.

22. Shkurte Sali Kozi, dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr.45, të datës 26.9.2005, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

23. Vezire Sul Sina, dënuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.268, datë 6.10.2004, i

falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

24. Violeta Qazim Danjeli, dënuar nga Gjykata e Rrethit Krujë, me vendimin nr.63, datë 16.7.2002, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

25. Valbona Myfit Frashëri, dënuar nga Gjykata e Rrethit Lushnjë, me vendimin nr.121, datë 17.7.2006, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

26. Vera Hysni Xhebraj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.432, datë 8.12.2006, i falet dënimi.

27. Vojsava Rifat Meta, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.02, datë 15.1.2007, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

28. Violeta Mark Molla, dënuar nga Gjykata e Rrethit Shkodër, me vendimin nr.314, datë 26.12.2003, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

29. Zamira Adem Fresku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Krujë, me vendimin nr.44, datë 29.7.1999, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

30. Zyra Kurt Kamberi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.382, datë 1.6.2000, i falet dënimi i mbetur.

31. Zoje Mark Xhafa, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mat, me vendimin nr.83, datë 30.11.2006, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.28, datë 4.3.2008

PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "ACR ENERGY" SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9, pika 3, nenin 13, pika 1, germa "ç", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenin 4, pika 1, germa "d", nenin 13 të "Rregullores së procedurave te licencimit", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve me nr.21, datë 4.4.2007, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s", neni 15 dhe neni 16, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 4.3.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "ACR Energy" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "ACR Energy" sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Pas fillimit të aktivitetit shoqëria "ACR Energy" sh.p.k. të informojë ERE-n lidhur me vlerat e sakta të sasisë së energjisë elektrike të kontraktuar për furnizimin me energji elektrike të Uzinës së Ferrokromit Elbasan, si dhe për vlerat e kapitalin financiar të përdorur për këtë qëllim.

3. Mosplotësimi i kësaj kërkese përbën kusht për heqjen e licencës.

4. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.29, datë 4.3.2008

PËR KËRKESËN E SHOQËRISË "ERS-08" SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9, pika 3, nenin 13, pika 1, germa "a", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 10, pika 1 të "Rregullores së procedurave të licencimit", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve me nr.21, datë 4.4.2007, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s", neni 15, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 4.3.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "ERS-08" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhim të energjisë elektrike nga këto centrale,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "ERS-08" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga këto centrale.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara në përputhje me kërkesat e "Rregullores për procedurat e licencimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.30, datë 4.3.2008

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ENPOWER ALBANIA" SHPK, PËR SHTYRJEN E VENDIMMARRJES PËR PAJISJEN ME LICENCË

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", neni 38, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 4.3.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k., për shtyrjen e vendimmarrjes për pajisjen me licencë,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., deri në paraqitjen nga ana e saj të vendimit të Këshillit të Ministrave, për marrjen në përdorim të fondit pyjor, si dhe të aktmarrëveshjeve apo dokumenteve të tjera që vërtetojnë marrjen në posedim/përdorim apo blerjen e zonave të cilat aktualisht janë pronë private e të tretëve.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, për përgatitjen e njoftimit për vendimin e dhënë nga ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 600 lekë
2. REGJISTRAT E NOTERISË 1000 lekë

BOTIME TË REJA
(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë

- Vendime të Gjykatës Kushtetuese 700 lekë
- Vendime të Gjykatës së Lartë 1000 lekë
- Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil 200 lekë
- Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave 273 lekë
- Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme
  (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)

Hyri në shtyp më 12.3.2008
Doli nga shtypi më 12.3.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2008

Çmimi 17 lekë